



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura VI  
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit

P-053

Prishtinë, më 4 dhjetor 2018, në orën 19:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**P R O C E S V E R B A L**

I MBLLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 4 DHJETOR 2018

**Në mbledhje morën pjesë:** Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Kujtim Shala, Aida Dërguti dhe Muferra Srbica-Shinik, nënkryetarë të Kuvendit.

**Nga grupet parlamentare:** Avdullah Hoti, Memli Krasniqi, Glauk Konjufca, Dardan Sejdiu, Ahmet Isufi, Bilall Sherifi dhe Albert Kinolli.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

**Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit:** Blerand Stavileci.

**Nga Administrata e Kuvendit:** Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

**Nga OSBE-ja:** Sanije Berisha.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit të Kuvendit, i zhvilloi punimet me këtë:

### **Rend dite**

1. Kërkesa e 40 deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme për debat parlamentar lidhur me dështimet e koalicionit qeverisës, të cilat kulmuan me mosliberalizim të vizave.

Kryetari i njoftoi të pranishmit se 40 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 69.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës kanë parashtruar kërkesë të re për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme më 4 dhjetor 2018, në orën 20:00, për debat parlamentar lidhur me dështimet e koalicionit qeverisës, të cilat kulmuan me mosliberalizim të vizave.

Lidhur me kërkesën e re të 40 deputetëve të Kuvendit të Kosovës për seancë të jashtëzakonshme diskutuan: Dardan Sejdiu, kryetar i GP të PSD-së; Bilall Sherifi, kryetar i GP të Nismës Socialdemokrate; Memli Krasniqi, kryetar i GP të PDK-së; Ahmet Isufi, kryetar i GP të AAK-së dhe Kujtim Shala, nënkryetar i Kuvendit, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pas diskutimeve të lartshënuara, vendosi që seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të mbahet të martën, më 4 dhjetor 2018, në orën 20:00, me këtë:

### **Rend dite**

1. Debat parlamentar lidhur me dështimet e koalicionit qeverisës, të cilat kulmuan me mosliberalizim të vizave

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 19:15 minuta.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:*

*Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*